

<b>EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME</b>	
<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Edukimit /Departamenti i Pedagogjisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Edukimi në fëmijërinë hershme</b>
<b>Niveli:</b>	<b>BA</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>III</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Salla P4</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Ass.Adelina Hajrullahu</b>
<b>Asistentja:</b>	<b>MA.Vlera Jashari</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:adelina.hajrullahu@uni-pr.edu">adelina.hajrullahu@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Lënda ofron njohuri bazike në fushën e edukimit parashkollor; filozofinë e edukimit parashkollor tradicional dhe atë të avancuar “me në qendër fëmija”; njohuri për ligjet e përgjithshme të zhvillimit të fëmijës parashkollor dhe karakteristikat individuale të tyre; rëndësinë e edukimit parashkollor për formësimin e personalitetit dhe fazat e tjera në jetë; qëllimin, detyrat, objektivat dhe parimet e edukimit parashkollor; faktorët e edukimit në moshën parashkollorë; veçanërisht për rolin e familjes – prindërve për mirëritjen dhe edukimin e parashkollorëve; funksionin e institucioneve parashkollorë për edukimin dhe socializimin e drejtë të fëmijëve, rolin e edukatores/edukatorit në edukimit dhe zhvillimin e parashkollorit, rolin e fëmijëve veçanërisht bashkëmoshatarë të përfshirë në institucion; rolin e aktiviteteve kurrikulare, etj., rolin e partneritetit midis faktorëve relevant të zhvillimit dhe edukimit të fëmijës, metodologjinë/parimet, metodat e mjetet/e edukimit parashkollor; strategjitë e edukimit parashkollor si dhe teoritë e ndryshme si bazament i tyre.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Studentët të kuptojnë konceptet themelore në fushën e pedagogjisë parashkollorë, të njohin, analizojnë dhe reflektojnë për problemet teorike të pedagogjisë parashkollorë, të reflektojnë për procesin dhe problemet aktuale të edukimit parashkollor që paraqiten në praktikën parashkollorë familjare dhe në institucione parashkollorë, të kuptojnë rolin e partneritetit Brenda faktorëve të institucionit parashkollorë, të institucionit me familjen dhe me komunitetin, të krahasojnë edukimin parashkollor ndër ne dhe në vendet e avancuara, të reflektojnë për strategjitë e ndryshme të edukimit parashkollorë, për përparësitë dhe mangësitë e tyre, të reflektojnë për filozofinë personale për edukimin parashkollor familjar dhe institucional.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegojnë konceptet themelore në fushën e edukimit parashkollor</li> <li>- Njohin dhe kuptojnë procesin e edukimit parashkollor familjar dhe parashkollorë të institucionalizuar, reflektojnë për filozofinë e edukimit tradicionale dhe atë të avancuar “me në qendër fëmija”</li> <li>- Reflektojnë për vlerat e edukimit parashkollor</li> </ul>

	<p>ndër ne dhe gjykojnë për nevojën e tejkalimit të qasjeve, pikëpamjeve, praktikave të vjetruara;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkathtësohen për partneritet me familjen dhe komunitetin.</li> <li>- Kanë formuar një filozofi personale të avancuar për edukimin parashkollor</li> </ul>
--	--

<b>Kontributinëgarkesën e studentit</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15/javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15/javë	15
Punë praktike	10	10 ditë	25
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare			
Detyratë shtëpisë	1	13	13
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4	3	12
Tjetër shëno: Projektet	1	14	14
<b>Totali</b>			<b>150</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Leksion I avancuar, diskutime, punë në grupe, punë në cifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies
<b>Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:</b>	Angazhimet / detyrat: 10 %; Prezantimet nga hulumtimi grupore ose ne dyshe– 10%; Detyrat individuale 20% elaborimi i një teme që nuk e ke ne prezantim me kolegen (projektet). Vlerësimi final-60%

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zuna, A.(2002). Edukimi i parashkollorit ne familje, Prishtinë.</li> <li>- Mato, E. &amp; Kamani,P. (2002). Në kërkim të njohjes, Tiranë.</li> <li>- Kamenov, E. (2002), Pedagogjia parashkollore, I – II, Beograd.</li> <li>- Brada, R. (2012). Pedagogjia parashkollore, Pejë.</li> <li>- Vadahi, F. (2002). Pedagogjia parashkollore , Tiranë.</li> <li>- Karaj, Th.(2010). Psikologjia e zhvillimit të fëmijës,. Tiranë.</li> <li>- Morrizon, G. (2011). Fundamentals od Early Childhood Education. Pearson.</li> <li>-</li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Selmani, L&amp;Zisi.A. (2006). Konceptimi dhe organizimi i veprimtarisë mësimore – edukative në arsimin parashkollore, Tiranë.</li> <li>- Gjevori, M. (2002). Prindëit edukatorët e parë të fëmijëve, Prishtinë.</li> <li>- Deva – Zuna, A.(2009). Partneriteti shkolle = familje – komunitet, sfidë vijanoze.Prishtinë.</li> </ul>

**Plani i dizajnuar i mësimi:**

<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Ligjërata : Njoftim me programin, obligimet
<b>Java e dytë:</b>	Nocionet bazë (Edukim, Zhvillim, Moshë parashkollore) – analiza e tyre
<b>Java e tretë</b>	Rëndësia, detyrat dhe objektivat e edukimit parashkollor
<b>Java e katër</b>	Teoritë mbi fëmijërinë e hershme
<b>Java e pestë</b>	Aspektet e zhvillimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme
<b>Java e gjashtë</b>	Institucionet parashkollore – funksioni i tyre
<b>Java e shtatë</b>	Funksioni pedagogjik i familjes – prindërve në edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore
<b>Java e tetë</b>	Vlerësimi i parë
<b>Java e nëntë</b>	Strategjitë e edukimit në fëmijërinë e hershme
<b>Java e dhjetë</b>	Procesi i adaptimit të fëmijëve në institucione parashkollore
<b>Java njëmbëdhjetë:</b>	Pedagogjizimi
<b>Java e dymbëdhjetë</b>	Korniza kurrikulare e edukimit parashkollor në Kosovë
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Format e partneritetit të institucionit parashkollor me familjen dhe komunitetin
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Vlerësimi i fëmijëve në fëmijërinë e hershme
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Prezentimi i projekteve – vlerësimi i dytë

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

- Studenti që ka 3 mungesa pa arsye, konsiderohet se humb të drejtën për t'iu shtruar provimit;
- Ushtrimet janë obligative
- Nuk lejohen telefonat celularë përveç në raste kur kërkohet nga mësuesi si mjet mësimor;
- Secili studentë ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala;
- Asnjëri nuk ka të drejtë t'i ndërhyjë tjetrit kur ai e ka fjalën;
- Lejohet “zhurma” e punës kur studentët punojnë në grupe;
- Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësuesi apo prezentohet puna e studentëve;
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme
- Dënohet cdo formë e kopjimit apo falsifikimit